



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me Rregulloren 2001/19, neni 1.3 pika (ç) mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë, në pajtim me nenin 4 paragrafi 4.8 të Ligjit 2003/23 Për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës, me rastin e aplikimit të parashtruesve të kërkesave për pensionet e aftësisë së kufizuar.

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë :

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 09/ 2004
PËR
PROCEDURAT E PARAQITJES SË KËRKESËS PËR PENSION TË AFTËSISË SË
KUFIZUAR

Neni 1

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ

1.1 Ky **Udhëzim Administrativ** ka për qëllim rregullimin dhe administrimin e procedurave për paraqitjen e kërkesës për pension të aftësisë së kufizuar .

Neni 2

Administrimi me pensionet e personave me aftësi të kufizuar

2.1 Administrimin e Procedurave të paraqitjes së kërkesës për pension të aftësisë së kufizuar në bazë të autorizimit të MPMS-së e bënë DAPK-ja (Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës).

2.2 DAPK-ja përmes Qendrës dhe gjashtë (6) zyrave rajonale e bënë administrimin e përditshëm të Procedurave të Paraqitjes së Kërkesave për Pensione të Aftësisë së Kufizuar.

Neni 3

Dhënia e informative parashtrusve të kërkesave

- 3.1** Nënpunësit e pensioneve në Qendër dhe nëpër zyrat rajonale do të ofrojnë ndihmë dhe informata parashtruesve të kërkesave për PPAK-të të cilët dëshirojnë të bëjnë kërkesë.
- 3.2** Nënpunësit e pensioneve obligohen që ti këshillojnë parashtruesit e kërkesave, se cilat dokumente duhet ti sjellin (p. sh. dokumenti identifikues i UNMIK-ut , të jetë më i vjetër se 18 vjeç dhe deri 65 vjeç, banor i Përherhem i Kosovës, se lëngon nga sëmundja fizike, mendore apo ndijore se paku 1 (një) vit para se të dorëzojë kërkesën.
- 3.3** Nëse parashtruesi i kërkesës nuk posedon dokumentet relevante , nënpunësi i pensioneve ka për obligim që t'a udhëzojë se ku mund të sigurohen ato dokumente.

Neni 4

Plotësimi i kërkesave

- 4.1** Nënpunësi i Pensioneve i jep formularët për parashtrusit e kërkesave.
- 4.2** Nënpunësi i Pensioneve nuk është i obliguar t'i plotësojë kërkesat e parashtruesve të Kërkesave por mund t'ju ofrojë ndihmë për të plotësuar kërkesën.
- 4.3** Kërkesa për pensionin e aftësisë së kufizuar duhet të nënshkruhet nga parashtruesi i kërkesës.
- 4.4** Përjashtim nga paragrafi 4.3 bëhet, kur parashtruesi nuk është i aftë të nënshkruajë kërkesën , atëherë nëpunësi i Pensioneve si dëshmitar vë shenjë në vendin e nënshkrimit.

Neni 5

Pranimi i kërkesave

- 5.1 Nënpunësi i Pensioneve me shumë kujdes duhet të kontrollojë çdo kërkesë që pranohet.
- 5.2 Parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kërkesë vetëm në një zyrë rajonale të banimit.
- 5.3 Nga nënpunësi i pensioneve kontrollohen validiteti dhe saktësia e shënimeve të prezentuara në kërkesë.
- 5.4 Nënpunësi i pensioneve siguron se kërkesa është plotësuar tërësisht, dhe se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur dëshmi relevante siç janë paraparë në paragrafin 3.2 të nenit 3.

Neni 6

Dokumentet identifikuese

- 6.1 Parashtruesi i kërkesës për pension të aftësisë së kufizuar, me rastin e aplikimit për këtë pension duhet të identifikohet përmes këtyre dokumentave:
 - a) Letërnjoftimin e lëshuar nga UNMIK-u,
 - b) Certifikatën e lindjes,
 - c) Vërtetimin se është banor i përhershëm i Kosovës.

Neni 7

Dëshmitë mjeksore

- 7.1 Përveç dokumenteve identifikuese parashtruesi i kërkesës, së bashku me kërkesën duhet të prezantojë edhe këto dëshmi mjeksore:
 - a) Diagnozën e gjendjes mjeksore –fizike, mendore, ndijore apo aftësinë e kufizuar prej së cilës vuan parashtruesi i kërkesës.
 - b) Ndikimin i gjendjes shëndetësore, sëmundjes apo aftësisë së kufizuar në punësim, duke përfshirë përshkrimin e saktë të aftësisë së kufizuar të parashtruesit të kërkesës.
 - c) Datën e paraqitjes së gjendjes shëndetësore, sëmundjes apo aftësisë së kufizuar.
 - ç) Vlerësimin e aftësisë për punë, të komisionit mjeksor.
 - d) Prognozën dhe propozimin mbi aftësinë e përhershme të kufizuar.

- 7.2** Nëse kërkesës nuk i bashkangjiten këto dëshmi ajo nuk do të pranohet dhe duhet t'i kthehet parashtruesit të kërkesës. Nënpunësi i Pensioneve duhet t'i tregojë arsyet e mospranimit të kërkesës.
- 7.3** Nëse fletëaplikacioni është në rregull, nënpunësi i Pensioneve duhet të bëjë:
- a) Fotokopjimin e dokumentit identifikues të UNMIK-ut, dhe dokumenteve të tjera.
 - b) T'ia dorëzojë dëftesën e pranimit parashtruesit të kërkesës duke e vulosur dhe nënshkruar.
- 7.4** Nënpunësi i Pensioneve është i vetmi person zyrtar që e plotëson seksionin e VI- të të kërkesës për DAPK-në
- 7.5** Dokumentet identifikuese dhe dëshmitë mjeksore të fotokopjuara futen brenda në dosje së bashku me kërkesën dhe nr.e telefonit (i domosdoshëm) për arsye të ekonomizimit të procedurës.
- 7.6** Çdo parashtruesi të kërkesës për pensionin e aftësisë së kufizuar i ndahet nr.i kërkesës në dosjen e tij, gjersa në pjesën e brendshme të dosjes bëhet fletëinventari i dëshmimeve të pranuar në dosje, duke shënuar datën e pranimit.
- 7.7** Me përmbushjen e pikës 7.4 përfundon faza nismëtare e procedimit të kërkesës për pensionin e aftësisë së kufizuar.

Neni 8

- 8.1** Ky Udhëzim Administrativ, do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet nga momenti kur fillon paraqitja e kërkesave për pensionin e aftësisë së kufizuar.

Ministri i MPMS-së
Ahmet Isufi

Prishtinë, Maj 2004